



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 2752 Prot.

Tiranë 04 / 05 /2017

URDHËR

Nr. 22, Datë 4.5 2017

“PËR

MIRATIMIN E STATUTIT QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE
FOLKLORIKE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë,

URDHËROJ:

1. Miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Udhri nr. 931, datë 23.10.2008 “*Për miratimin e ndryshimeve në statutin e Qëndrës Kombtare të Veprimtarive Folklorike*” shfuqizohet.
3. Ngarkohet Qëndra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike për zbatimin e këtij Urdhri dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor për komunikimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Mirela KUMBARO FUKXHU





QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE FOLKLORIKE

STATUTI

I

QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE FOLKLORIKE

MIRATOHET
MINISTRI
Mirela KUMBARO FURXHI

Tiranë 2017

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky Statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Qendrës Kombëtare të Veprimitarive Folklorike (në vijim QKVF).

Neni 2
Statusi juridik

1. QKVF është institucion kombëtar me statusin e personit juridik, publik në varësi të Ministrisë së Kulturës. QKVF është institucion publik qendor, i pavarur nga subjektet politike dhe grupet e tjera të interesit.
2. Aktiviteti i QKVF-së ushtrohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” Konventat e fushës të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, Statutin, Rregulloren e FFTK-ve dhe Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj.

Neni 3

Selia, vula dhe stema

1. QKVF ka selinë në Tiranë, ka logon, vulën dhe faqen e saj zyrtare në internet. Vula e institucionit prodhohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 474, dt 10.07.2003 “Per menyren e perdorimit te stemës së Republikës, si dhe raportin e permasave te saj” (i ndryshuar), Ajo ka vulën e saj në formë rrethore ku përcaktohet emërtesa ligjore e institucionit, “*Republika e Shqipërisë, Qendra Kombëtare Veprimitarive Folklorike, Tiranë*”.
2. QKVF ka edhe logon e saj sipas formatit bashkëlidhur.

KREU II
PARIMET DHE DETYRAT

Neni 4
Parimet

QKVF në veprimtarinë e saj mbështet dhe përkrah lirinë e informacionit dhe të informimit si një e drejtë themelore e qytetarëve. Siguron qasje të barabartë për të gjithë.

Neni 5

Detyrat dhe funksionimi i QKVF-së

1. QKVF me veprimtarinë e saj zbaton legjislacionin në fushën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (kombëtare dhe ndërkontinentale); mbron dhe promovon listën kombëtare të dukurive të «Trashëgimisë kulturore jomateriale» të shpallura si të tilla dhe përmblidhet detyrimet në kuadër të strategjive dhe politikave nga Ministria Kulturës për Trashëgiminë Kulturore Jomateriale.
2. QKVF me veprimtarinë e saj punon për evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e kësaj trashëgimie.
3. QKVF është institucion i vetëm shtetëror i cili ndjek dhe zbaton veprimtarite folklorike kombëtare, organizon dhe menaxhon Festivalin Folklorik Kombëtar Tipologjike dhe bashkëorganizon Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës mbështetur në rregulloret e këtyre veprimtarive kombëtare të miratuara nga Ministri i Kulturës.
4. QKVF trajnon dhe kualifikon të gjithë ata që menaxhojnë, interpretojnë, ekzekutojnë ose ekspozojnë kulturën dhe artin popullor si këngëtarë, valltarë, instrumentistë popullorë, mjeshtërë popullorë në fushën e kulturës jomateriale, etj.
5. QKVF organizon dhe administron çdo vit, me fonde të siguruara nga buxheti i shtetit, të miratuara për QKVF-në, veprimtaritë Kombëtare të përcaktuara në planin vjetor të saj. QKVF mbështet dhe merr pjesë në bashkëorganizimin e veprimtarive të rëndësishme vendore dhe rajonale të folklorit.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërinstiucional

1. Për realizimin e funksioneve të saj, QKVF bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucione të specializuara shkencore, kulturore e artistike, publike apo private, pushtetin vendor, Organizatat Joqeveritare (OJQ), si dhe Median e shkruar dhe vizive.

2. QKVF për kryerjen e veprimtarisë së saj, bashkërendon punën me institucionet kulturore, artistike dhe shkencore qendrore e vendore, me Akademinë e Shkencave dhe Universitetet, me specialistët e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale pranë D.R.K.K-ve, me bashkitë dhe Qendrat e Artit, shoqata kulturore folklorike dhe individë të ndryshëm që merren me Trashëgiminë Kulturore Jomateriale.
3. QKVF bashkëpunon dhe krijon lidhje me institucione homologe ose organizma të tjera në vende të ndryshme të botës për të bërë të njojur trashëgiminë kulturore jomateriale shqiptare, në përputhje me dipozitat e Ligjit Nr. 43/2016, dt. 21.04.2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Realizimi i veprimtarisë

1. QKVF trajton si pasuri kombëtare edhe vlera të trashëgimisë kulturore jomateriale të krijuara nga pakicat kombëtare dhe linguistike në Shqipëri dhe i propogandon ato në veprimtaritë e organizuara prej saj dhe në bashkëpunim me të tretët. \
2. QKVF krijon lidhje dhe organizon veprimtari të përbashkëta me grupe artistike e shoqata kulturore shqiptare të diasporës që veprojnë jashtë kufijve shtetërorë. QKVF e trajton si pasuri kombëtare, trashëgiminë jo materiale, që ruhet e zhvillohet nga shqiptarët jashtë kufijëve shtetërorë, si në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Greqi dhe Diasporë.
3. QKVF organizon aktivitete multikulturore në marrëveshje me institucione të tjera kulturore e artistike, shoqata kulturore, persona juridikë dhe fizikë që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë mbështetur në programin vjetor.

Neni 8

Botimet

1. Për popullarizimin dhe promovimin e pasurive të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale QKVF bën botime të ndryshme etnomuzikore, koreografike, ilustrative të kulturës jomateriale, si dhe organizon veprimtari edukuese dhe informuese me brezin e ri.
2. Organizon aktivitete kushtuar figurave të shquara të trashëgimisë kulturore jomateriale, studiuesve dhe mbledhësve të folklorit dhe bartësve të kësaj trashëgimie sipas fushave respektive.
3. QKVF krahas planit vjetor të Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare ka për detyrë dhe organizimin e programeve apo botimeve me rol edukativ për brezin e ri në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale duke qënë se edukimi përmes kulturës është

një detyrë parësore e shtetit që institucionet e kulturës të mos prodhojnë vetëm produkte të mirëfillta profesionale që i destinohen publikut të rritur dhe publikut profesional, por në mënyrë të ndërgjegjshme të programojnë edhe rolin e tyre edukativ.

Neni 9

Të Drejtat

1. QKVF gëzon të drejtat mbi të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet e organizuara prej saj.
2. QKVF gëzon të drejtën ekskluzive të dhënies së autorizimit të regjistrimit në mbajtës zëri ose figure të veprimtarive folklorike që organizon. E drejta e shpërndarjes dhe e përdorimit të këtyre veprave bëhet sipas dispozitave të, Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

KREU III

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 10

Struktura dhe organika

1. Struktura dhe organika e QKVF, propozohen nga Ministri i Kulturës, dhe miratohet nga Kryeministri në përputhje me ligin Nr. 9000, dt. 30. 01. 2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe ligjit Nr. 90/2012 dt 27. 09. 2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
2. Veprimtaria e QKVF, realizohet mbi bazën e programit vjetor.

Neni 11

Rregullorja e funksionimit të brendshëm

1. Marrëdhëniet juridike të punonjësve të QKVF rregullohen në bazë të ligjit Nr. 7961, dt. 12. 07. 1995 “Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).
2. QKVF veprimtarinë e saj të brendshme e ndërton në bazë të Rregullores së Brendshme që përcakton detyrat dhe të drejtat e të gjithë elementëve të strukturës, duke synuar realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.
3. Rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit miratohet nga Drejtori i QKVF.

Neni 12

Kompetencat e Drejtorit

1. Drejtori i QKVF emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Ministri i Kulturës, sipas procedurave të përcaktuara në VKM Nr. 173, dt. 07. 03. 2003, “Për emërimin, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrat, Këshillit të Ministrave dhe Ministrive”.

2. Drejtori i QKVF ka kompetenca si më poshtë:

- a) planifikon, drejton dhe koordinon veprimtarinë e QKVF në përputhje me legjislacionion në fuqi, Statutin e institucionit dhe Rregulloren e Brendshme të funksionimit të tij;
- b) drejton punën administrative të QKVF-së;
- c) përfaqëson QKVF në marrëdhënie me të tretët;
- d) mbikëqyr dhe menaxhon efektivitetin e punonjësve dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional;
- e) emëron dhe liron në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullore së Brendshme të QKVF të gjithë vartësit e tij;
- f) nxjerr urdhëra dhe udhëzime me karakter të brendshëm në përputhje me misionin dhe detyrat e përcaktuara në këtë statut.
- g) drejtori i QKVF është anëtar i Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Jomateriale.
- h) Miraton rregulloren e brendshme te Institucionit.

Neni 13

Punësimi

1. Punësimi në QKVF bëhet me kontratë individuale pune në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. QKVF vendos marrëdhëniet e punës me stafin përmes kontratave me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar sipas nevojave administrative institucionale.
3. Rregullimi i marrëdhënieve të punës përsa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, masave disiplinore etj përcaktohen në rregulloren e brendëshme të Institucionit.

4. Afatet dhe procedurat e njoftimit referuar procedurave të parashikuara nga Kodi i Punës dhe Kodi i Procedurave Admistrative, për çdo rast dhe natyrë të shkeljeve disiplinore, janë si më poshtë:

- a) Njoftimi për ecurinë disiplinore i drejtohet me shkrim punonjësit të paktën 72 orë përpara takimit dhe të bisedojë me të. Njoftimi drejtohet në vendim e punes ne rast prezencë në punë apo në adresën e vendbanimit të deklaruar nga punonjësi në momentin e lidhjes së kontratës.
- b) Në takim përveç Titullarit është e detyrueshme prezanca e punonjësit të shërbimeve mbështetëse dhe një punonjësi tjetër të institucionit të përcaktuar nga Titullari. Në rast të mungëses së punonjësit të shërbimeve mbështetëse titullari përcakton një punonjës tjetër të institucionit.
- c) Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit për fillimin e ecurisë disiplinore konkrete dhe te vërtetuar dhe i jep atij mundësinë për tu shprehur si verbalisht ashtu edhe shkresërisht.
- d) Vendimi për dhënen e masës disiplinore njohtohet me shkrim brenda një afati 48 ore deri në një javë pas takimit.

5. Për takimet e zhvilluara, institucioni mban procesverbalin përkatës i cili duhet të nëshkruhet nga të gjithë pjesmarrësit. Në rast të refuzimit të nënshkrimit për pranimin e procesverbalit, refuzimi duhet të bëhet i motivuar. Në rast se punonjësi ndaj të cilit është filluar masa disiplinore nuk paraqitet në takim dhe ka marrë njoftim për datën e caktuar, atëherë procesverbalit nënshkruhet nga titullari dhe punonjësit e përcaktuar në gërmën b pika 4 e këtij nenit.

6. Çdo procedurë e realizuar në kundërshim me parashikimet e këtij neni konsiderohet absolutisht i palvefshem.

KREU IV

ORGANIZIMI FINANCIAR

Neni 14

Organizimi financiar

QKVF është institucion buxhetor. Burimet e financimit të QKVF janë:

- a. Buxheti i shtetit;
- b. Të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e organizuara;
- c. Sponsorizimet dhe donacionet;
- d. Të ardhura të tjera të ligjshme;

Neni 15

Të ardhurat buxhetore

1. QKVF është një institucion buxhetor shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës.
2. QKVF në kuadër të realizimit të projekteve të sja, mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme nga subjekte private ose organizata të ligjshme, shqiptare apo edhe të huaja në bazë të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar.
3. Fondi për buxhetin e QKVF-së miratohet nga Ministri i Kulturës, menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të ligjit për buxhetin vjetor.
5. Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga QKVF-ja sipas legjislacionit në fuqi, Vendimit nr. 432, datë 28.6.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore” si dhe Udhëzimit të perbashkët te Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Financës.

Neni 16

QKVF paraqet në Ministrinë e Kulturës, çdo 30 qershor programin vjetor për vitin e ardhshëm, të shoqëruar me relacionin.

Neni 17

Auditimi financiar

Administrimi dhe veprimtaria financiare e Q.K.V.F -së auditohet nga Ministria e Kulturës, si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për auditim.

KREU V

NDRYSHIMET NË STATUT

Neni 18

Statuti i QKVF-së miratohet nga Ministri i Kulturës. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Statut propozohen nga Drejtori i Institucionit.

Neni 19

Ndryshimet në Statut

Çdo shtesë apo ndryshim miratohet nga Ministri i Kulturës, me propozim të Drejtorit të QKVF.

Adresa: Rr.“Aleksandër Moisiu” nr.76 TIRANE, Shqipëri,

Tel.04 225 45 80

Info@folklor.gov.al ëëë.folklor.gov.al

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri i Kulturës.